



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 78

Tiranë – E martë, 7 maj 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 2.5.2024	Për autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit, për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së partneritetit strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Oracle Corporation”..... 8539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 2.5.2024	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2024, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 8539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 2.5.2024	Për miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor, si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore në fushën e ndërtimit..... 8540
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 2.5.2024	Për miratimin e kategorive të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë në pronësi ose administrojnë pajisje apo instalime nën presion, që i nënshtrohen detyrimit për t’u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, si dhe kufirin minimal të përgjegjësisë së tyre, që mbulohet nga kontrata e sigurimit..... 8550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 2.5.2024	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8553
Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 3.5.2024	Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”..... 8553
Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 9, datë 3.5.2024	Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar 8563



VENDIM
Nr. 263, datë 2.5.2024

**PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT, PËR NEGOCIMIN
DHE NËNSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT
STRATEGJIK NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË
“ORACLE CORPORATION”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 31, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes së partneritetit strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Oracle Corporation”.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 266, datë 2.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NË BUXHETIN E VITIT
2024, PËR BASHKËSITË FETARE, QË
KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE
ME KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 2, 3, 4, 5 e 6, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin, nga buxheti i shtetit, të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, dhe të ligjit nr. 97/2023,

“Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 113 000 000 (njëqind e trembëdhjetë milionë) lekësh, nga buxheti i vitit 2024, e miratuar për të mbështetur financiarisht bashkësitë fetare, përdoret, si më poshtë vijon:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 33 840 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekë, të ndarë në:

i. 17 040 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e dyzet mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 71 (shtatëdhjetë e një) punonjës të administratës;

ii. 16 800 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 70 (shtatëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 26 400 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e mijë) lekë, të ndarë në:

i. 13 200 000 (trembëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës të administratës;

ii. 13 200 000 (trembëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 26 400 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekë, të ndarë në:

i. 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 (dyzet) punonjës të administratës;

ii. 16 800 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 70 (shtatëdhjetë) punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar;

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 26 360 000 (njëzet e gjashtë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të ndarë në:

i. 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë për financimin, deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 25 (njëzet e pesë) punonjës të administratës;



ii. 13 360 000 (trembëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, si kontribut në ndërtimin e Teqesë së Shtutit, Gjirokastër;

iii. 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë, si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesëpreventivat e paraqitura prej saj në kërkesën e vitit 2024, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur.

2. Kalimi i fondit, përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, bëhet njëherësh, brenda muajit maj të vitit 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 267, datë 2.5.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE, PËR MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT
DISIPLINOR, SI DHE RREGULLAT
PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE NË FUSHËN
E NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14/2, 14/5 e 14/7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për fillimin e procedurës disiplinore, për mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor, si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore në fushën e ndërtimit.

2. Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 41, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së

licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, miratuar me vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe pika III, e kreut VII, të rregullores “Për kriteret, procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, miratuar me vendimin nr. 42, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohen pas ngritjes dhe funksionimit të komisionit disiplinor, sipas këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, institucionet publike që kryejnë oponencën dhe çdo autoritet publik që mbikëqyr veprimtarinë e ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

RREGULLAT
**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE, PËR MËNYRËN E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT
DISIPLINOR, SI DHE RREGULLAT PËR
ZHVILLIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE NË FUSHËN E NDËRTIMIT**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për fillimin e procedurës disiplinore, mënyrën e funksionimit të komisionit disiplinor, si dhe rregullat për zhvillimin e procedurës disiplinore, të drejtat dhe detyrimet e subjektit gjatë procedurës disiplinore, caktimin e masave disiplinore dhe çdo çështje tjetër që lidhet me procedurat disiplinore.



Neni 2 Objekti

Këto rregulla përcaktojnë:

- a) përgjegjësitë dhe kompetencat e komisionit disiplinor;
- b) rregullat për ushtrimin e veprimtarisë administrative dhe procedurale të komisionit disiplinor në paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit, që lidhet me procedurën disiplinore;
- c) rregullat për krijimin, trajtimin, qarkullimin, përdorimin, ruajtjen e dokumentacionit, që bëhet pjesë e procedurës disiplinore, si dhe sigurimin e aksesit të subjekteve ndaj të cilëve është marrë një masë disiplinore.

Neni 3 Fusha e veprimtarisë së komisionit disiplinor

1. Komisioni disiplinor ka si fushë të veprimtarisë së tij trajtimin e çdo çështjeje, që ka të bëjë me shkeljet disiplinore, ecurinë e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen për masën përkatëse.
2. Komisioni disiplinor është kompetent edhe për çdo çështje tjetër të parashikuar me ligj, në përputhje me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni.

Neni 4 Parimet e përgjithshme

Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë komisioni disiplinor, janë ligjshmëria, transparenca, mosdiskriminimi, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave, profesionalizmi, përgjegjësia, pavarësia, integriteti, paanësia dhe eficientia.

Neni 5 Konflikti i interesit

1. Anëtari i komisionit disiplinor i pranishëm, përkatësisht, në mbledhjen e komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, për veten ose për një anëtar tjetër, lidhur me një çështje të rendit të ditës, është i detyruar për sa më poshtë:
 - a) të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës; dhe

b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse; dhe

c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes përkatëse.

2. Çdo anëtar i komisionit disiplinor, brenda 24 orëve pas marrjes së rendit të ditës dhe materialeve për një mbledhje të ardhshme të komisionit, dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse, deklarohet konflikti i interesit ose pengesën ligjore. Anëtari i komisionit disiplinor, i cili ka deklaruar konflikti i interesit ose pengesën, nuk merr pjesë në diskutimin ose votimin e çështjes përkatëse në komision.

3. Në rastet e konfliktit të interesit, anëtari kërkon heqjen dorë nga diskutimi ose votimi. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga kryetari i komisionit disiplinor. Kur dorëheqjen e jep kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.

4. Nëse një anëtar ka dijeni se një anëtar tjetër i komisionit disiplinor ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, e deklarohet atë menjëherë pas marrjes dijeni dhe në çdo rast para votimit të çështjes përkatëse.

5. Anëtari për të cilin pretendohet konflikti i interesit ose pengesa ligjore deklarohet qëndrimin e tij lidhur me këtë pretendim. Nëse anëtari vlerëson se pretendimi qëndron, sipas rastit, ai nuk merr pjesë në diskutimin apo votimin e çështjes përkatëse ose kërkon heqjen dorë. Kur kërkesa për heqje dorë bëhet në mbledhje të komisionit, diskutimi ose votimi i çështjes në fjalë mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

6. Anëtarët e komisionit disiplinor duhet të tërhiqen nga shqyrtimi i një procedimi disiplinor në rastet kur ekzistojnë një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Anëtari njofton kryetarin për heqjen dorë nga shqyrtimi i procedimit disiplinor brenda 2 (dy) ditëve nga data e marrjes dijeni të pengesës ligjore, ndërsa në rastin e heqjes dorë të kryetarit, njoftohet nënkryetari i komisionit disiplinor. Me njoftimin e heqjes dorë, komisioni disiplinor vijon shqyrtimin e procedimit disiplinor pa anëtarin e tërhequr.

7. Personi fizik apo juridik, ndaj të cilit po ushtrohet procedimi, mund të kërkojë përjashtimin e një anëtarit të komisionit nga procedimi disiplinor, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi i procedimit disiplinor. Kërkesa për



përfshirjen e një anëtarit bëhet me shkrim, i drejtohet kryetarit dhe përmban të gjitha provat e mundshme, në të cilat mbështetet, ndërsa kur paraqitet ndaj kryetarit kërkesa, i drejtohet anëtarit të dytë të caktuar nga ministri përgjegjës për ndërtimin.

8. Procedimi disiplinor pezullohet deri në shqyrtimin e kërkesës për përfshirjen e anëtarit ose të kryetarit.

9. Komisioni disiplinor merr vendimin për përfshirjen ose konfirmimin në procedimin disiplinor të anëtarit ose kryetarit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës për përfshirje. Anëtarit ose kryetarit i komisionit disiplinor, ndaj të cilit është paraqitur kërkesa, nuk merr pjesë në shqyrtimin e kërkesës për përfshirjen e tij. Në rastet e përfshirjes, organi kolegjal funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përfshirur.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Komisioni disiplinor

1. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:

- a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ndërtimin;
- b) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- c) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme;
- ç) një përfaqësues nga Shoqata për Autonomi Vendore.

2. Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për ndërtimin caktohen me urdhër të ministrit të kësaj ministrie brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ministria përgjegjëse për ndërtimin, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kërkon caktimin e përfaqësuesve në komisionin disiplinor nga organet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni. Organet e ngarkuara duhet të caktojnë përfaqësuesit në komisionin disiplinor brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e kërkesës së përcjellë nga ministria përgjegjëse për ndërtimin.

4. Kryetari dhe anëtarët e komisionit disiplinor zgjidhen për një mandat 5-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Kryetari i komisionit është një nga përfaqësuesit e caktuar nga ministri përgjegjës për ndërtimin, në përputhje me pikën 2,

të këtij neni. Nënkrjetari zgjidhet nga komisioni në mbledhjen e parë të tij.

5. Mandati i kryetarit dhe i anëtarit të komisionit disiplinor mbaron, kur:

- a) përfundon mandati 5-vjeçar;
- b) jep dorëheqjen;
- c) mbush moshën e pensionit;
- ç) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- d) largohet nga detyra funksionale në institucionin që përfaqëson.

6. Anëtarët e komisionit disiplinor shpërblehen për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në komision, sipas akteve nënligjore në fuqi, që përcaktojnë masën e shpërblimit për anëtarët e këshillave, të bordeve apo komisioneve në njësitë e qeverisjes qendrore. Në rastin kur nënkrjetari i komisionit disiplinor kryen funksionin e kryetarit, për mbledhjet që do të kryejë këtë funksion, do të shpërblehet me shpërblimin e përcaktuar për kryetarin.

7. Detyrën e sekretarisë së komisionit disiplinor e kryen drejtoria përgjegjëse për licencimin në ministrinë përgjegjëse për ndërtimin.

Neni 7

Kuorumi dhe mbledhja e komisionit disiplinor

1. Mbledhja e komisionit disiplinor është e vlefshme vetëm, kur në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij. Komisioni mbledhet në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga kryetari. Komisioni mbledhet edhe me propozim të një anëtarit.

2. Kryetari i komisionit disiplinor cakton rendin e ditës për mbledhjen, pas konsultimit me anëtarët. Para mbledhjes, çdo anëtar i komisionit mund të kërkojë shtimin e çështjeve të tjera në rendin e ditës. Ato përfshihen nëse votojnë pro kërkesës jo më pak se dy anëtarë.

3. Mbledhjet e komisionit drejtohen nga kryetari i komisionit.

4. Komisioni ka të drejtë të kërkojë çdo dokumentacion, i cili konsiderohet i nevojshëm dhe ndihmës për veprimtarinë e tij sipas ligjit.

5. Çdo anëtar i komisionit ka të drejtë të dëgjohet për mendimin e tij lidhur me çështjen që diskutohet.

6. Rregullat për pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen në distancë zbatohen për aq sa është e mundur.



7. Pjesëmarrja në mbledhjet e komisionit disiplinor është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, kryetari, ose në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tri mbledhje të njëpasnjëshme, anëtari i dytë i zgjedhur nga ministri përgjegjës për ndërtimin, njofton menjëherë organin që e ka emëruar dhe ministrin përgjegjës për ndërtimin. Në këtë rast, organi emërues cakton anëtarin e ri, në përputhje me rregullat për caktimin e anëtarëve, sipas dispozitave të nenit 6, të këtij kreu.

8. Komisioni disiplinor merr vendim në lidhje me shtyrjen e mbledhjes, pranueshmërinë e provave, zgjidhjen e çështjes, si dhe çdo çështje tjetër që e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

9. Komisioni disiplinor merr vendime vetëm për çështje, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

10. Marrja e vendimeve në mbledhjen e komisionit disiplinor bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur.

11. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e një vote. Në asnjë rast, e drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtar tjetër të komisionit disiplinor ose personave të tretë.

12. Vendimet e komisionit disiplinor merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Në rastet kur votimi rezulton i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Abstenimi nuk lejohet. Kryetari i komisionit voton i fundit. Anëtari në pakicë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga komisioni disiplinor.

13. Votat e anëtarëve të komisionit disiplinor regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

14. Dokumentimi i veprimtarisë së komisionit disiplinor gjatë mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes, i cili mbahet nga sekretaria e komisionit disiplinor dhe përmban:

- a) datën dhe vendin e mbledhjes;
- b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;
- c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;
- ç) vendimet që u morën në mbledhje, argumentet për vendimmarrje, afatet e përcaktuara në vendimmarrje;
- d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyetimet përkatëse;

dh) rezultatet e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar;

e) përcaktimin e mbylljes së diskutimeve.

15. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, si dhe nga kryetari e sekretari.

16. Vendimmarrja e komisionit disiplinor mbahet në 2 (dy) kopje dhe vuloset nga zyra e arkivit të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin. Njëra kopje dorëzohet në zyrën e arkivit të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", dhe rregulloret në zbatim të tij, dhe 1 (një) kopje, në praktikën e komisionit disiplinor.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit dhe të anëtarëve të komisionit

1. Kryetari i komisionit disiplinor është përgjegjës dhe kryen detyrat, për:

a) funksionimin e duhur të komisionit disiplinor;

b) mbikëqyrjen dhe administrimin e punës së komisionit disiplinor;

c) administron relacionin në të cilin shpjegohen shkeljet disiplinore së bashku me dokumentacionin përkatës, të paraqitur nga autoritetet e përcaktuara në nenin 9, të kreut II, të kësaj rregulloreje, për procedimin disiplinor ndaj subjektit për të cilin është depozituar propozimi;

ç) përgatitjen për mbledhjen;

d) caktimin e orës, të datës dhe të vendit të mbledhjes dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të komisionit disiplinor. Kur në hapjen e mbledhjes nuk është arritur kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e saj, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt;

dh) caktimin rendit të ditës dhe kryesimin e mbledhjeve të komisionit disiplinor;

e) ndarjen e barabartë dhe të drejtë të detyrave, duke marrë në konsideratë angazhimin profesional të anëtarëve të komisionit disiplinor;

ë) caktimin e specialistit përgjegjës nga sekretaria, për të asistuar anëtarin e komisionit disiplinor në përmbushjen e detyrave të tij hetimore;



f) të hapur, mbyllur e drejtuar mbledhjen e komisionit disiplinor, duke siguruar mbarëvajtjen e saj, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;

g) të kërkuar informacion, nëse ka kërkesa paraprake nga palët, të cilat vlerësohen nga komisioni disiplinor;

gj) të informuar anëtarët e komisionit disiplinor lidhur me detyrimin për t'u shprehur brenda 2 (dy) ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit, nëse kanë konflikt interesi apo dyshime mbi paanësinë e tyre në vendimmarrje, si dhe personin fizik apo juridik, subjekt të procedimit disiplinor, nëse ka konflikt interesi me njërin prej anëtarëve të komisionit disiplinor;

h) nënshkrimin e të gjitha akteve të nxjerra nga komisioni disiplinor;

i) kryerjen e ballafaqimeve dhe saktësimeve të kërkuara nga anëtarët e tjerë, si dhe për të njoftuar mbylljen e diskutimeve;

j) caktimin e datës së mbledhjes jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e relacionit, në të cilin shpjegohen shkeljet disiplinore dhe dokumentacionin shoqërues. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë çdo anëtar i komisionit.

k) ndarjen e detyrave ndaj anëtarëve për fillimin e hetimit disiplinor;

l) caktimin e datës së seancës dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore.

Në rastet kur kryetari nuk thërret mbledhjen brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, ose nuk merr pjesë në të, pavarësisht shkakut, detyrat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ushtrohen nga nënkryetari.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarit të komisionit janë, si më poshtë vijon:

a) të marrë pjesë, të respektojë dhe të zbatojë procedurat për mbledhjet e komisionit disiplinor;

b) të realizojë brenda afateve kohore detyrat e caktuara nga kryetari i komisionit disiplinor;

c) të informojë kryetarin sa më herët të jetë e mundur, me shkrim ose në rrugë elektronike, për konfirmimin për pjesëmarrje në mbledhje;

ç) të mos nxjerrë asnjë informacion të ndjeshëm nga mbledhjet e komisionit;

d) të shmangë favorizimin, anshmërinë ose diskriminimin mbi çfarëdo baze, kur shqyrton

çështje, merr vendime ose voton për çështje që i paraqiten komisionit disiplinor;

dh) të përdorë ekskluzivisht adresën e postës elektronike zyrtare të komisionit disiplinor për të gjitha komunikimet e brendshme e të jashtme që lidhen me punën dhe aktivitetet e komisionit disiplinor;

e) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi;

ë) tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, nëse ndodhet para kushteve të përcaktuara në shkronjën “gj”, të pikës 1, të këtij neni;

f) voton për vendimet që merr komisioni disiplinor, me përjashtim të rastit kur tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, sipas shkronjës “ë”, të kësaj pike.

KREU III RREGULLAT PËR PROCEDIMIN DISIPLINOR

Neni 9

Organizimi i procedimit disiplinor

1. Procedimi disiplinor fillon me paraqitjen e propozimit pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtimin nga zhvilluesi, inspektorati vendor ose kombëtar, kryetari i bashkisë, në rastet kur ndërtimi është kryer në territorin nën juridiksionin e bashkisë, çdo autoritet publik që mbikëqyr veprimtarinë e ndërtimit ose çdo person fizik ose juridik kur gjatë procesit të ndërtimit janë konstatuar shkelje të legjislacionit të ndërtimit e të planifikimit.

2. Me marrjen e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, ministria përgjegjëse për ndërtimin e regjistron atë dhe, brenda 5 ditëve, ia dërgon sekretarisë së komisionit disiplinor.

3. Kryetari i komisionit disiplinor përcakton datën, vendin dhe orën e seancës dëgjimore, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së propozimit për fillimin e procedurës disiplinore.

4. Propozimi shoqërohet me relacion, në të cilin shpjegohen shkeljet disiplinore të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Dokumentacioni shoqërues duhet të konkretizojë shkeljen disiplinore të pretenduar dhe konkretisht:



a) oponencat teknike, ku pasqyrohen hartimi i studimeve ose i projekteve në kundërshtim me standardet teknike në fuqi;

b) oponencat, që pasqyrojnë studimet ose projektimet me të meta më shumë se një herë nga i njëjti subjekt;

c) oponencat, ku pasqyrohen të metat e projektit të zbatimit në atë masë që mund të paraqesë rrezik për shëndetin e sigurinë publike, mjedisin ose trashëgiminë kulturore;

ç) aktet e konstatimit të mbajtura në objekt nga Inspektorati Vendor/Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;

d) aktin e kolaudimit në rastet kur kolaudimi i objektit është kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;

dh) çdo dokumentacion tjetër i papërmendur në këtë nen, që gjykohet i nevojshëm për hetimin e çështjes.

5. Sekretaria e komisionit disiplinor mbledh informacionin e nevojshëm dhe përgatit dokumentacionin, të cilin ia vënë në dispozicion komisionit disiplinor.

6. Komisioni disiplinor, nëpërmjet sekretarisë, njofton palët për zhvillimin e seancës dëgjimore të paktën 10 ditë përpara.

7. Komisioni disiplinor, gjatë shqyrtimit të rasteve të propozuara për procedim disiplinor, mund të kërkojë informacion nga gjykata, nëse çështja objekt shqyrtimi nga komisioni disiplinor është duke u shqyrtuar edhe në gjykatë ose për çdo informacion apo fakt tjetër, që do të shërbente për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

Neni 10

Të drejtat dhe detyrimet e subjektit gjatë procedurës disiplinore

1. Komisioni disiplinor njofton palët për fillimin e procedurës disiplinore.

2. Subjektet kërkuese për fillimin e procedurës disiplinore kanë të drejtë:

a) të mbrojnë akuzat e ngritura ndaj subjekteve të licencuara nëpërmjet përfaqësuesve të emëruar prej tyre në seancën dëgjimore të përcaktuar nga komisioni disiplinor;

b) të sjellin gjatë seancës dëgjimore dokumentacione dhe materiale plotësuese.

3. Subjektet e licencuara, të cilat janë në shqyrtim për fillimin e procedurës disiplinore, kanë të drejtën:

a) të mbrohen personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në seancën dëgjimore;

b) të paraqesin dokumentacione, që lidhen me çështjen në shqyrtim;

c) të ankimohen te ministri përgjegjës për ndërtimin, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, për çdo vendim të komisionit disiplinor.

4. Subjektet kërkuese dhe ato të licencuara kanë detyrimin:

a) të paraqiten në seancën dëgjimore. Në mungesën e dy seancave të njëpasnjëshme, gjykimi vazhdon pa praninë e subjekteve.

b) të paraqesin çdo dokumentacion apo provë plotësuese, që do të kërkohet nga komisioni disiplinor.

Neni 11

Ankimi

1. Ankimi paraqitet nga pala ankuese ose nga përfaqësuesi i zgjedhur prej saj brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit të komisionit disiplinor.

2. Ankimi paraqitet në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, qartë dhe kuptueshëm, si dhe duhet të përmbajë:

a) adresimin e ankesës në ministrinë përgjegjëse për ndërtimin;

b) emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e ankuesit dhe/ose të përfaqësuesit të tij, në rastin e personave fizikë;

c) emërtimin e personit juridik ankues, përfaqësuesin e tij ligjor, vendbanimin ose vendqëndrimin dhe/ose përfaqësuesin e zgjedhur;

ç) vendimin e komisionit disiplinor kundër të cilit paraqitet ankimi;

d) parashtrimin e objektit dhe shkaqeve të ankimit;

dh) aktet procedurale, të cilat i bashkëlidhen ankimit, të tilla si:

i. akti i përfaqësimit, në rast se ankimi paraqitet nga përfaqësuesi i zgjedhur i ankuesit;

ii. kopje të vendimit të komisionit disiplinor, objekt ankimi;

iii. dokumente, prova, apo materiale të tjera, që shoqërojnë ankimin, në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

e) nënshkrimin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij, në rast se ankimi paraqitet prej këtij të fundit, sipas tagrave të dhëna shprehimisht në aktin e përfaqësimit.



3. Ministri përgjegjës për ndërtimin, pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 15 ditëve kalendarike:

a) lënien në fuqi të vendimit të marrë nga komisioni disiplinor;

b) kthimin për rishqyrtim, në komisionin disiplinor, të vendimit të marrë.

4. Ndaj vendimit të ministrit apo vendimit përfundimtar të komisionit disiplinor, çdo subjekt ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente administrative, brenda 45 ditëve kalendarike.

5. Ankuesi mund të heqë dorë nga ankimi deri sa nuk është marrë një vendim në lidhje me të. Në rast të heqjes dorë nga ankimi, pushon shqyrtimi i ankimit.

Neni 12

Procedura disiplinore

1. Komisioni disiplinor e zbaton procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të subjektit të licencuar, sipas përcaktimit në nenin 14/7, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, të ndryshuar, dhe cakton masat disiplinore pas evidentimit të shkeljeve të dispozitave, që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe veprimtarinë e tij.

2. Masat disiplinore, të përcaktuara në nenin 14/8, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, të ndryshuar, që komisioni disiplinor u jep projektuesit, zbatuesit, mbikëqyrësit, drejtuesit teknik dhe kolaudatorit arsyetohen e merren sipas një procedure transparente.

Neni 13

Masat disiplinore për projektuesin

Masat disiplinore që merren për projektuesin gjatë procedurës disiplinore për shkeljet e përcaktuara në pikat 1/a dhe 1/b, të nenit 14/4, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, të ndryshuar, siç janë përcaktuar në nenin 14/8, të po këtij ligji, janë, si më poshtë vijon:

a) Paralajmërim me shkrim, nëse konstatohet se:

i. shkalla e pakujdesisë nuk është në shkallën që të sjellë rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit; dhe

ii. shkelja konstatohet për herë të parë.

b) Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nëse konstatohet që kryerja e së njëjtës shkelje është bërë më shumë se një herë;

c) Urdhërimin e subjektit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikë profesionale dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të veprimtarisë profesionale, në rast se komisioni disiplinor konstaton që:

i. gjatë ushtrimit të profesionit të licencuar nuk është respektuar kodi i etikës profesionale; ose

ii. mënyra e aplikimit të standardeve shqiptare dhe të atyre evropiane në projektim nuk është sipas përcaktimeve në to dhe udhëzuesve për zbatimin e tyre, dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencës së energjisë; ose

iii. nuk është respektuar legjislacioni në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

ç) Pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet, në rast se:

i. probabiliteti dhe rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që dëmi mund të riparohet pa sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit; dhe

ii. dëmi financiar është në atë shkallë që të mos kalojë shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, e përcaktuar në policën e sigurimit e cilësuar në kontratën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

d) Heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit, në rast se probabiliteti dhe rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që:

i. dëmi nuk mundet të riparohet; dhe

ii. sjell pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit; si dhe

iii. dëmi financiar është në shkallën që kalon shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, e përcaktuar në policën e sigurimit e cilësuar në kontratën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Neni 14

Masat disiplinore për mbikëqyrësin e punimeve/grupin e mbikëqyrësve

Për mbikëqyrësin e punimeve/grupin e mbikëqyrësve, në rast se kryejnë shkelje në bazë të përgjegjësisë për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, komisioni disiplinor merr



masat sipas llojit të dëmit të shkaktuar, si më poshtë vijon:

a) Paralajmërim me shkrim, në rast se shkelja ka ardhur si pasojë e pasaktësisë së dokumenteve, mosvërtetësisë së dokumenteve, cilësisë jo të mirë të punimeve të ndërtimit apo mosnjoftim të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, në rastet e konstatimit të ndryshimit të projektit, si dhe kur:

i. ndodh për herë të parë; dhe

ii. është në shkallën që nuk sjell rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit.

b) Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nëse konstatohet që gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, mbikëqyrësi, në rastet kur ka konstatuar se ka mospërputhje të punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit, legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, nuk ka kryer një nga veprimet e mëposhtme:

i. nuk ka urdhëruar pezullimin e punimeve të ndërtimit;

ii. nuk ka njoftuar menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, ku kryhen punimet e ndërtimit;

iii. nuk ka njoftuar menjëherë autoritetin përgjegjës të planifikimit;

iv. sipas rastit, nuk ka njoftuar menjëherë Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

c) Urdhërimin e subjektit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikën profesionale dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të veprimtarisë profesionale, në rast se komisioni disiplinor konstaton një nga rastet e mëposhtme:

i. Shpeshtësia e kryerjes së të njëjtës shkelje të përmendur në pikën 1/a, të këtij neni, është më shumë se një herë;

ii. Gjatë ushtrimit të profesionit të licencuar, nuk janë respektuar rregullat e etikës profesionale dhe është shfaqur mosnjohje e kodit të etikës profesionale;

iii. Mënyra e aplikimit të standardeve shqiptare dhe të atyre evropiane në projektim nuk është e sakta, sipas përcaktimeve në to dhe udhëzuesve për zbatimin e tyre, dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, higjieno-sanitare, si dhe eficiencës së energjisë; si dhe

iv. Mosrespektim i legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

ç) Pezullim i licencës për një periudhë nga një deri në pesë vjet, në rast se shkelja ka ardhur si pasojë e mosurdhërimit të pezullimit të punimeve të ndërtimit, ose mosnjoftimit të menjëhershëm të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, ku kryhen punimet e ndërtimit, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ose mosnjoftimit të zhvilluesit dhe sipërmarrësit për dëmin e shkaktuar, si dhe shkallën e tij kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike, si dhe probabiliteti e rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkeljet është në atë shkallë që:

i. dëmi mund të riparohet pa sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit; dhe

ii. dëmi financiar të jetë në atë shkallë që të mos kalojë 20% të vlerës së investimit të pjesës së dëmtuar, pavarësisht se kjo mbulohet nga kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Në rastin e moslidhjes së kontratës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale për çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij.

d) Heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit në rastet kur pasoja ka ardhur nga mospërmbushja e rregullt e detyrave, sipas legjislacionit në fuqi për mbikëqyrjen e ndërtimeve ose mosnjoftimi i organeve shtetërore përgjegjëse për shkeljet e kryera nga zbatuesi i punimeve, si dhe kur probabiliteti e rëndësia e dëmit është në atë shkallë, që:

i. nuk mundet të riparohet dhe ka sjellë pasoja për rrezikimin e jetës e sigurinë në përdorim të objektit; si dhe

ii. dëmi financiar është në atë shkallë që kalon 20% të vlerës së investimit të pjesës së dëmtuar.

Neni 15

Masat disiplinore për zbatuesin e punimeve

Për zbatuesin e punimeve, në rast se kryen shkelje në bazë të përgjegjësisë për realizimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik, si dhe sigurimin e cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose



evropiane, komisioni disiplinor, sipas llojit të dëmit të shkaktuar, merr masat e mëposhtme:

a) Paralajmërim me shkrim, nëse konstatohet që:

i. pakujdesia në ushtrimin e profesionit nuk është në shkallën që të sjellë rrezikimin e jetës, sigurinë në përdorim të objektit; dhe

ii. shkeljet, si: rifillimi i punimeve të ndërtimit pa marrë të gjitha masat përkatëse për të cilat mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrjes ka pezulluar punimet, mospagimi i çdo detyrimi administrativ të vendosur nga inspektorati, ndryshimet e projektit zbatohen të pamiratuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit apo zbatimi i punimeve nuk është në përputhje me legjislacionin për planifikimin e territorit, ndodhin për herë të parë.

b) Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nëse konstatohet që:

i. shpeshësia e kryerjes së të njëjtës shkelje e përcaktuar në pikën 1/a, të këtij neni, është më shumë se një herë; ose

ii. zbatuesi i punimeve realizon punimet e ndërtimit në mospërputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

c) Pezullim i licencës për një periudhë nga një deri në pesë vjet, në rast se:

i. probabiliteti dhe rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që dëmi mund të riparohet pa sjellë pasoja për rrezikimin e jetës, si dhe sigurinë në përdorim të objektit; dhe

ii. dëmi financiar është në atë shkallë që të mos kalojë shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, e përcaktuar në policën e sigurimit e cilësuar në kontratën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale; dhe

iii. nuk realizohen në kohë punimet për riparimin e dëmit të shkaktuar palëve të treta në infrastrukturën publike; dhe

iv. nuk sigurohet cilësia e materialeve të ndërtimit dhe e produkteve të ndërtimit, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe standardet kombëtare ose evropiane.

ç) Heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit, kur zbatuesi i punimeve ka rifilluar punimet e ndërtimit pa u konfirmuar nga mbikëqyrësi dhe pa u miratuar nga zhvilluesi për riparimet e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën publike gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe pa u zhdëmtuar financiarisht pala e dëmtuar për

periudhën e riparimit, si dhe nëse probabiliteti e rëndësia e dëmit të ardhur nga shkelja:

i. është në atë shkallë që dëmi nuk mundet të riparohet; dhe

ii. ka sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit.

Neni 16

Masat disiplinore për drejtuesin teknik

Për drejtuesin teknik, në rast se kryen shkelje në bazë të përgjegjësisë për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit, si dhe për tërësinë e masave organizative, teknike e teknologjike, ekonomike e financiare, higjienike e mjedisore për zbatimin e legjislacionit të punës e atë teknik, që garantojnë kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekt dhe të atyre ndihmëse në kantier, në kushte të sigurta për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e mjedisit, komisioni disiplinor merr masat sipas llojit të dëmit të shkaktuar, si më poshtë:

a) Paralajmërim me shkrim, nëse për shkak të mosmarrjes së masave për ndreqjen e të metave ose mosbërjen e shënimeve përkatëse në librin e kantierit konstatohet që:

i. shkelja e pakujdesisë nuk është në shkallën që të sjellë rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit;

ii. shkelja është për herë të parë:

b) Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nëse konstatohet që është kryer një nga shkeljet e mëposhtme:

i. shpeshësia e kryerjes së të njëjtës shkelje, e përcaktuar në pikën 1/a, të këtij neni, është më shumë se një herë;

ii. mosmarrja në dorëzim e dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor;

iii. mosmarrja e masave të sigurimit teknik dhe mospajisja me mjete mbrojtëse përkatëse e punonjësve;

iv. mosverifikimi i saktësisë së lidhjes së objektit me terrenin dhe të piketimit të tij;

v. mosvënia në dispozicion të mbikëqyrësit e librit të kantierit dhe e dokumentacionit të kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi;



vi. mosbërja e njoftimeve brenda kohës së duhur për inspektimin e punimeve të maskuara;

vii. mosmarrja e kampioneve;

viii. moskryerja e provave të analizave, që parashikohen në rregullat teknike ose kërkohen shtesë nga mbikëqyrësi;

ix. mosparaqitja fotografike dhe e kasetave filmike e çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve e të punimeve;

c) Urdhërimin e subjektit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikën profesionale dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të veprimtarisë profesionale, në rast se komisioni disiplinor konstaton që, gjatë ushtrimit të profesionit, nuk është respektuar një nga rastet e mëposhtme:

i. Kodi i etikës profesionale;

ii. legjislacioni i ndërtimit;

iii. marrëdhëniet e ndërsjella të bashkëpunimit e të komunikimit;

iv. mënyra e kontrollit të standardeve shqiptare dhe e atyre evropiane;

v. mënyra e kontrollit të masave mbrojtëse dhe sigurisë në punë.

ç) Pezullim të veprimtarisë për një periudhë nga një deri në pesë vjet, në rast se probabiliteti dhe rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që dëmi mund të riparohet pa sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe pasoja ka ardhur nga:

i. moszbatimi i përpiktë i projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike, ndryshimeve të miratuara, kërkesave të kushteve teknike të zbatimit në fuqi, specifikimeve teknike të kontratës dhe radhës teknologjike të punimeve;

ii. mossigurimi i cilësisë së materialeve të ndërtimit dhe të produkteve të ndërtimit, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e projektit dhe standardet kombëtare ose evropiane;

iii. mosrespektimi i procedurës për vendosjen e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit në objekt;

iv. mosinstruktimi dhe riinstruktimi i të gjithë punonjësve çdo fillim muaji, në përputhje me programin mujor të punës.

d) Heqje përfundimtare e së drejtës së ushtrimit të profesionit, nëse probabiliteti dhe rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që dëmi nuk mundet të riparohet dhe ka sjellë pasoja për rrezikimin e jetës nga:

i. moszbatimi i përpiktë i projektit, sipas vizatimeve, përshkrimeve teknike, ndryshimeve të miratuara, kërkesave të kushteve teknike të zbatimit në fuqi, specifikimeve teknike të kontratës dhe radhës teknologjike të punimeve;

ii. moszbatimi i urdhrit të mbikëqyrësit për prishjen dhe ribërjen, brenda periudhës së korrigjimit të defekteve, të punimeve që rezultojnë me shkelje të kushteve teknike të zbatimit dhe standardeve e specifikimeve teknike.

Neni 17

Masat disiplinore për kolaudatorin

Për kolaudatorin, në rast se kryen shkelje në bazë të përgjegjësiave për kolaudimin e punimeve të ndërtimit për kontrollin e përputhshmërisë së punimeve të zbatimit me projektin, me kushtet e lejes së ndërtimit, me standardet e rregullat teknike, si dhe me parashikimet e legjislacionit në fuqi, komisioni disiplinor merr masat sipas llojit dhe dëmit të shkaktuar, si më poshtë vijon:

a) Paralajmërim me shkrim, nëse konstatohet një nga shkeljet e mëposhtme dhe shkelja ka ndodhur për herë të parë, si dhe nuk është në shkallën që të sjellë rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit:

i. kur kolaudatori ose grupi i kolaudimit nuk ka lënë detyra me shkrim për punimet që duhet të kryhen;

ii. nuk janë përcaktuar afatet e përfundimit të detyrave të lëna, kur janë vërejtur defekte gjatë verifikimit;

iii. mosrealizimi i objektit, në përputhje me projektin dhe lejen e ndërtimit;

iv. mospërputhje e vlerës preventive dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar.

b) Vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit, nëse konstatohet:

i. shpeshtësia e kryerjes së të njëjtës shkelje, e përcaktuar në pikën 1/a, të këtij neni, është më shumë se një herë; ose

ii. kolaudatori nuk ka verifikuar realizimin e projektit, në përputhje me kontratën, dhe nuk ka kryer kolaudimin edhe gjatë proceseve të punimeve, sipas përcaktimeve në udhëzimi nr. 3, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.



c) Urdhërimin e subjektit për të kryer trajnim shtesë, përfshirë trajnim në etikë profesionale dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të veprimtarisë profesionale, në rast se komisioni disiplinor konstaton që gjatë ushtrimit të profesionit të licencuar nuk janë respektuar:

- i. legjislacioni në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë; ose
- ii. standardet në ndërtim; ose
- iii. kushtet dhe rregullat ndërtimore si në projektim dhe në zbatim; ose
- iv. cilësia e materialeve të ndërtimit.

ç) Pezullim nga detyra për një periudhë nga një deri në pesë vjet, në rast se realizimi i punimeve nuk është kryer në përputhje me standardet dhe rregullat teknike, si dhe probabiliteti e rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që dëmi mund të riparohet pa sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit;

d) Heqje përfundimtare e licencës për ushtrimin e profesionit kur akti i kolaudit bëhet pa kryer përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi, si dhe nëse probabiliteti e rëndësia e dëmit të mundshëm nga shkelja është në atë shkallë që:

- i. dëmi nuk mundet të riparohet; dhe
- ii. sjellë pasoja për rrezikimin e jetës dhe sigurinë në përdorim të objektit.

VENDIM

Nr. 268, datë 2.5.2024

PËR MIRATIMIN E KATEGORIVE TË OPERATORËVE EKONOMIKË, TË CILËT KANË NË PRONËSI OSE ADMINISTROJNË PAJISJE APO INSTALIME NËN PRESION, QË I NËNSHTROHEN DETYRIMIT PËR T’U PAJISUR ME KONTRATËN E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË CIVILE, SI DHE KUFIRIN MINIMAL TË PËRGJEGJËSISË SË TYRE, QË MBULOHEËT NGA KONTRATA E SIGURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2016, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, me propozimin e

zëvendëskryeministrit dhe ministri të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është:

1. Përcaktimi i kategorive të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë në pronësi ose administrojnë pajisje apo instalime nën presion, në funksion të një veprimtarie tregtare dhe që duhet t’i nënshtrohen detyrimit për t’u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile.

2. Përcaktimi i kufirit minimal të përgjegjësisë që mbulohet nga kontrata e sigurimit, me qëllim garantimin e sigurisë së mjedisit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve nga rreziqet e shkaktuara nga këto pajisje dhe instalime.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen për të gjithë operatorët ekonomikë, që administrojnë apo shfrytëzojnë pajisje dhe instalime nën presion, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 32/2016, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

2. Sigurimi i detyrueshëm kryhet vetëm pasi operatori ekonomik ka regjistruar pajisjen/ instalimin nën presion pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas përcaktimeve të nenit 7, të ligjit nr. 32/2016.

Neni 3

Kategoritë e operatorëve ekonomikë që i nënshtrohen detyrimit për t’u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile

Kategoritë e operatorëve ekonomikë, të cilët kanë në pronësi apo administrojnë pajisje/instalime nën presion, në funksion të një veprimtarie tregtare dhe që duhet t’i nënshtrohen detyrimit për t’u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile janë, si më poshtë vijon:

1. Subjekte që zhvillojnë aktivitet tregtar dhe ofrojnë shërbime për të tretë në fushat:

- a) Restorant/shërbime ushqimi;



- b) Akomodim/turizëm;
 - c) Shërbim social;
 - ç) Shërbim shëndetësor;
 - d) Institucione arsimore;
 - dh) Institucion/ndërmarrje shtetërore;
 - e) Ndërtim;
 - ë) Prodhim/përpunim/tregtim produkte jo-ushqimore;
 - f) Prodhim/përpunim/tregtim produkte ushqimore;
 - g) Shoqëri tregtimi fluidi me shumicë;
 - gj) Shoqëri tregtimi fluidi me pakicë;
 - h) Shoqëri nxjerrje/prodhimi dhe përpunimi fluide/hidrokarbure;
 - i) Shoqëri prodhimi dhe përpunimi gazrash teknike/mjekësore;
 - j) Shoqëri tregtimi gazrash teknike/mjekësore me shumicë;
 - k) Shoqëri tregtimi gazrash teknike/mjekësore me pakicë;
 - l) Transportim i bombolave të ndryshme;
 - ll) Transportim me autocisterna;
 - m) Shërbime hekurudhore;
 - n) Shërbime detare;
 - nj) Aktivitete të turizmit detar;
 - o) Subjektet fizike dhe juridike, që operojnë në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, që gjatë veprimtarisë së tyre përdorin enë nën presion (sistemet e mbrojtjes nga zjarri).
2. Subjektet që përdorin dhe/ose administrojnë enë nën presion, sipas volumit:
- a) Kaldajë avulli dhe ujë të nxehur në prodhimtari;
 - b) Pajisje nën presion stacionare/rezervuar GLN (gazi i lëngshëm i naftës);
 - c) Bombola GLN (pajisje të transportueshme nën presion-PTNP);
 - ç) Enët e thjeshta nën presion/stacionare;
 - d) Enët kriogjenike për gazrat teknike hidrogjen/oksigen (përfshirë PTNP-të);
 - dh) Bombolat e gazrave teknike dhe mjekësore (PTNP);
 - e) PTNP të tjera;
 - ë) Rezervuar hidrokarbur/lëndë djegëse;
 - f) Linjat teknologjike/industriale;
 - g) Pajisjet për shuarjen e zjarrit dhe pajisjet stacionare për shuarjen e zjarrit.
3. Kategoritë e operatorëve, lloji i pajisjes/instalimit, sipas nivelit të riskut përcaktohen në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij projektvendimi.

Neni 4

Kufijtë minimalë të përgjegjësisë që mbulohen nga kontrata e sigurimit

1. Me qëllim garantimin e mbulimit të dëmeve që mund të shkaktohen ndaj mjedisit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve, kufijtë minimalë të përgjegjësisë do të jenë, si më poshtë vijon:

a) Pajisje/implante në presion me rrezik të ulët 10 (dhjetë) milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 20 (njëzet) milionë lekë në agregat;

b) Pajisje/implante në presion me rrezik të mesëm 20 (njëzet) milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 40 (dyzet) milionë lekë në agregat;

c) Pajisje/implante në presion me rrezik të lartë 35 (tridhjetë e pesë) milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 70 (shtatëdhjetë) milionë lekë në agregat;

ç) Pajisje/implante në presion me rrezik shumë të lartë 50 (pesëdhjetë) milionë lekë për ngjarje sigurimi dhe 100 (njëqind) milionë lekë në agregat.

2. Kategoritë e operatorëve ekonomikë, që i nënshtrohen detyrimit për t'u pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, mund të kryejnë sigurim edhe mbi kufijtë minimalë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Neni 5

Parashikime të veçanta

1. Të gjitha kategoritë e operatorëve ekonomikë, sipas këtij vendimi, do të jenë përgjegjëse për të përmbushur detyrimin për të lidhur kontratën e sigurimit të përgjegjësisë civile, si dhe për rinovimin e saj pa shkëputje, përgjatë të gjithë periudhës së shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion për të garantuar mbulimin e dëmeve që mund të shkaktohen ndaj mjedisit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Shtojca 1

Kategoritë e operatorëve, lloji i pajisjes/instalimit, sipas nivelit të riskut:

Nr.	PNP - Pajisje nën presion	Volum*Presion	Niveli i riskut
1	Kaldajë avulli dhe ujë të nxehur në prodhimtari	Deri në 300 kg/orë deri në 2000 kg/orë	Risk i ulët
		2 ton/orë deri në 37 ton/orë	Risk i mesëm
		37 ton/orë deri në 122 (përfshirë) ton/orë	Risk i lartë
2	PNP nën presion stacionare/ rezervuar GLN	150 litra deri në 3000 litra	Risk i lartë
		3000 litra deri në 5000.000 (përfshirë) litra	Risk shumë i lartë
3	Bombola GLN (PTNP)	Nën 5 litra	Risk i lartë
		5 litra deri në 150 litra	Risk shumë i lartë
4	Enët e thjeshta nën presion/stacionare	Rezervuar ajri, azoti	Risk i mesëm
5	Enët kriogjenike për gazrat teknike hidrogjen/oksigen (përfshirë PTNP-të)	Deri në 1000 litra	Risk i mesëm
		Mbi 1000 litra	Risk shumë i lartë
6	Bombolat e gazrave teknike dhe mjekësore (PTNP)	Nga 10 litra deri në 150 litra	Risk i lartë
		Bombola të lëndëve të rrezikshme	Risk shumë i lartë
7	PTNP të tjera	Klasi 2-GLN	Risk shumë i lartë
		Klasi 3-Të lëngshme	Risk shumë i lartë
		Automjete që transportojnë PNP	Risk shumë i lartë
8	Rezervuar hidrokarbur/lëndë djegëse	Të gjitha llojet	Risk shumë i lartë
	Linjat teknologjike/industriale	Tubacionet	Risk shumë i lartë
		Naftë bruto në zonat naftëmbajtëse	Risk shumë i lartë
		Hidrokarbure/gazi në terminale detare	Risk shumë i lartë
		Hidrokarbureve në impiantet e përpunimit të gazit natyror	Risk shumë i lartë
		Rezervuar fluidi të rrezikshme	Risk shumë i lartë
		Kaldajë vaji	Risk shumë i lartë
		Seperator gazi	Risk shumë i lartë
		Këmbyes nxehtësie	Risk shumë i lartë
		Kokë pusi	Risk shumë i lartë
		Rezervuar lëndë të rrezikshme	Risk shumë i lartë
		PNP-të teknologjike	Risk shumë i lartë
		Autokllavat/sterilizues	Risk i mesëm
		PNP vakuumi	Risk i mesëm
9	Të tjera	Cisterna/rezervuar/PNP-të e të gjitha llojeve	Risk shumë i lartë



VENDIM

Nr. 270, datë 2.5.2024

**PËR NJË SHITESË DHE NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 420,
DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN
E CEREMONIALIT SHTETËROR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në kapitullin VI, pika 6, të tekstit të “Ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, bashkëlidhur vendimit, bëhet shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në nën pikën 6.2 shtohet nënndarja “22 nëntor – Dita e Alfabetit”;

b) Në nën pikën 6.4, nënndarja “20 nëntor – Dita e Alfabetit”, shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 8, datë 3.5.2024

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË
PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË
MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI
DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat e pranimit, pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

2. Shpallja e vendeve të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.

3. Portali “Mësues për Shqipërinë” krijohet për punësimin e mësuesve në arsimin parauniversitar, në bazë merite, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe shanse të barabarta.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrit dhe të pranimit të mësuesve në një vend të lirë pune në institucionet arsimore parauniversitare publike. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

5. Thirrja për konkurrim shpallet sipas profileve lëndore për mësuesit, sipas zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP).

6. Procesi i konkurrit për mësuesit, zhvillohet për:

a) kandidatin që plotëson kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtrimin e profesionit të mësuesit;

b) kandidatin që ka marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë” të thirrjes paraardhëse dhe që dëshiron të përmirësojnë rezultatin e tij;

c) kandidatin që kryen provimin e licencimit, e kalon me sukses këtë provim dhe zgjedh që në të njëjtën ditë të kryejë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

7. AKAP-ja ka detyrimin të publikojë në portalin “Mësues për Shqipërinë” përgjatë të gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar publik, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji. Vendet e lira të punës që krijohen për shkak të mbushjes së moshës për pension pleqërie, publikohen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së daljes në pension të mësuesit.



8. AKAP-ja/DRAP-ja publikojnë në faqet e tyre zyrtare, shpalljen për konkurrim në portalin “Mësues për Shqipërinë”, e cila përmban këto të dhëna:

a) profilet lëndore për të cilat do të zhvillohet konkurrimi, si dhe dokumentet që do të vlerësohen në konkurrim;

b) fazat në të cilat do të kalojë konkurrimi, vlerësimi i dosjes dhe testimi i informatizuar;

c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

d) datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak dhe përfundimtar të kandidatëve;

e) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për të gjitha fazat e konkurrit;

f) mënyrën e njofimit dhe komunikimit me kandidatët.

9. Regjistrimi i kandidatëve bëhet në *e-albania*, në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Afati për kryerjen e aplikimit dhe ngarkimit të dokumentacionit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes.

10. Kandidati që zhvillon provimin e licencimit në QSHA dhe e kalon atë me sukses, ka të drejtë që në të njëjtën ditë të marrë pjesë edhe në testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Kandidati që nuk zgjedh të marrë pjesë në testimin e informatizuar në të njëjtën ditë në të cilën jep provimin e licencimit, për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit, i nënshtrohet procedurave të konkurrit sipas rregullave të parashikuara në këtë udhëzim në rast të konkurrit në portal në thirrjen e radhës.

KREU II

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

1. AKAP-ja krijon komisionet e vlerësimit të dosjeve (KVD) në nivel rajonal (sipas ndarjes së DRAP-eve).

2. KVD-ja përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

a) 2 (dy) anëtarë nga DRAP-ja, kryetar i komisionit është drejtori i DRAP-së;

b) 1 (një) anëtar nga AKAP-ja;

c) 2 (dy) anëtarë nga ZVAP-ja në juridiksion të DRAP-së, nga të cilët të paktën njëri të jetë në profesion mësues.

3. Specialisti i burimeve njerëzore dhe juristi në DRAP, kryejnë rolin e sekretariatit teknik për

mbajtjen e të dhënave për dokumentet e kandidatëve.

4. KVD-ja kryen këto detyra:

a) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në shtojcën 1, të këtij udhëzimi;

b) evidenton kandidatët që mbartin pikët, si dhe rastet kur kandidatët kanë ngarkuar në portal dokumente shtesë;

c) shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e marrë;

d) përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar;

e) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;

f) dërgon elektronikisht në AKAP dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit listën me renditjen e pikëve për çdo kandidat.

KREU III

PROCEDURA E KONKURRIMIT

1. Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

a) vlerësimin e dosjes deri në 30 pikë;

b) vlerësimin e testit të informatizuar deri në 70 pikë. Për kandidatët që në të njëjtën ditë zhvillojnë provimin e licencimit dhe të testimit të informatizuar, vlerësimi përfshin pikët e testit të licencës dhe pikët e testit të informatizuar, të konvertuara nga QSHA-ja në 70 pikë gjithsej.

2. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar regjistrohen në *e-albania*, në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Kandidatët për mësues që aplikojnë për herë të parë, në momentin e aplikimit ngarkojnë në portal dokumentet e mëposhtme, të cilat janë të detyrueshme:

a) kopje të diplomës/ave për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe listës së notave;

b) kopje të licencës për ushtrimin e profesionit, për kandidatët që e kanë detyrim ligjor;

c) formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas modelit të shtojcës 3, të këtij udhëzimi;

d) deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi;



e) çdo dokument tjetër që disponon, që sipas shtojcës 1 të këtij udhëzimi vlerësohet me pikë, të cilat nuk janë të detyrueshme.

4. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentet e detyrueshme sipas pikës 3, të këtij kreu, nuk kualifikohet.

5. Kandidati aplikon në DRAP-në ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në tri ZVAP ku dëshiron të punësohet.

6. Kandidati që zotëron më shumë se një licencë, ka të drejtë të konkurrojë në profilet sipas licencave përkatëse.

7. Kandidati që ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm ngarkon në portal dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu.

8. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe dëshiron të marrë pjesë në testim, do të renditet në listën përfundimtare me pikët e testimit të fundit. Kandidati i cili nuk paraqet dokumente shtesë pranë KVD-së dhe nuk dëshiron të marrë pjesë në testimin e radhës, i mbarten pikët ekzistuese në renditjen e re deri në dy vjet.

9. Kandidati i cili dëshiron të punojë si mësues në dispozicion ose si mësues ndihmës, krahas aplikimit për profilin përkatës, në aplikimin e tij duhet të zgjedhë edhe opsionin “Mësues në dispozicion” ose “Arsim special”.

10. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve firmosin deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas modelit të shtojcës 6, të këtij udhëzimi.

11. KVD-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune pas përfundimit të afatit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e ngarkuar nga kandidatët dhe harton listën emërore për çdo profil, sipas çdo ZVAP-je. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.

12. KVD-ja dërgon në AKAP listën paraprake të përgatitur si më sipër, për t’a publikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Në të njëjtën ditë që publikohet lista paraprake, KVD-ja njofton në formë elektronike kandidatët e kualifikuar, lidhur me vlerësimin e dosjes, si dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar dhe arsyen e moskualifikimit.

13. Kandidati ka të drejtën e ankimit në adresën e portalit ose në adresën nga e cila merr njoftimin, brenda 3 (tri) ditëve pune nga dita e shpalljes, lidhur me vlerësimin e dosjes. KVD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së ankesës, e

shqyrton atë dhe i kthen përgjigje ankuesit, duke reflektuar ndryshimin e pikëve, nëse ankesa ka qenë e drejtë. Pas shqyrtimit të ankesave, AKAP-ja publikon në *web* listën e fazës së parë të vlerësimit të dosjeve.

14. Në fazën e dytë “Testimi i informatizuar”, merr pjesë kandidati që aplikon për herë të parë, i cili në aplikimin *online* ka zgjedhur opsionin “Aplikoj për herë të parë” dhe ka kaluar me sukses fazën e vlerësimit të dosjeve, si dhe kandidati që ka zgjedhur opsionin “Mbart pikët e dosjes dhe do të marrë pjesë në testim”. AKAP-ja përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar.

15. Kalendar i testimit të informatizuar hartohet nga QSHA-ja dhe publikohet në portalin “Mësues për Shqipërinë”, si dhe në faqet zyrtare të AKAP-së, DRAP-së, QSHA-së.

16. Kandidati ka të drejtë të paraqesë ankim në QSHA dhe për dijeni në AKAP, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e rezultatit të testimit të informatizuar. QSHA-ja në bashkëpunim me ASCAP-in, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e paraqitjes së ankesës, e shqyrton atë, i kthen përgjigje ankuesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve, kur pranohet ankesa.

17. AKAP-ja bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale, që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin e informatizuar. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Lista publikohet në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen zyrtare të institucionit.

18. AKAP-ja i përcjell njësive të vetëqeverisjes vendore listën me renditjen e kandidatëve për mësuesit e arsimit parashkollor.

19. Kandidati që kryen provimin e licencimit dhe e kalon me sukses këtë provim, ka të drejtë që në të njëjtën ditë të kryejë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

20. QSHA-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga përfundimi i sezonit të provimeve të licencimit për profesionin e rregulluar të mësuesit, dërgon në AKAP listën e kandidatëve që kanë kaluar me sukses provimin e licencimit dhe kanë marrë pjesë edhe në testimin e informatizuar për pjesëmarrje në portal, me pikët e fituara sipas parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu.

21. Kandidati, i përcaktuar në pikën 19 të këtij kreu, brenda 10 (dhjetë) ditëve, regjistrohet në e-



albania në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe ngarkon dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu.

22. KVD-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga përfundimi i afatit, sipas pikës 21 të këtij kreu, bën vlerësimin e dosjeve dhe i komunikon me *email* çdo kandidati pikët e dosjes. Kandidati kanë të drejtën e ankimit për pikët e dosjeve brenda 3 (tri) ditëve. KVD-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune, shqyrton ankesat nëse ka dhe bën njoftimin me *email* për vlerësimin përfundimtar. Rezultatit përfundimtar të pikëve të dosjeve e dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në AKAP.

23. Për kandidatët e përcaktuar në pikën 19 të këtij kreu, AKAP-ja mbledh pikët e dosjes të me pikët e testimit dhe rendit në listën ekzistuese të portalit, sipas profilit dhe sipas ZVAP-ve, ku kanë paraqitur kërkesën për punësim, si dhe e publikon në faqën zyrtare të institucionit. Një kopje e listës së përditësuar i dërgohet DRAP-eve dhe në MAS.

KREU IV

PROCEDURA E ZGJEDHJES SË VENDIT TË PUNËS DHE EMËRIMI I MËSUESVE

1. ZVAP-ja identifikon vendet e lira të punës që krijohen në institucionet arsimore në varësi dhe i dërgon në DRAP me *email* dhe me shkresë zyrtare. Vendet e lira të punës që krijohen në fillim të vitit shkollor dërgohen në DRAP, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga fillimi i vitit shkollor, ndërsa gjatë vitit shkollor dërgohen menjëherë. DRAP-ja raporton vendet e lira të punës në AKAP, e cila i shpall ato në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

2. Vend i lirë pune do të konsiderohet çdo ngarkesë mësimore, sipas udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin, pavarësisht nëse është në një apo në disa institucione arsimore parauniversitare. Në rast se ngarkesa mësimore është në disa institucione arsimore parauniversitare, mësuesi punësohet në institucionin arsimor ku ka më shumë ngarkesë mësimore.

3. Për vendet e lira të punës për çdo ZVAP, kandidati njoftohet nga KVD-ja në DRAP, në varësinë e të cilit është vendi i lirë i punës. Njoftimi bëhet përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit *online*.

4. Kandidati i cili është renditur me numrin më të madh të pikëve në profilin që ka konkurruar, ka të drejtën të zgjedh i pari vendin e lirë të punës.

Kandidati që nuk paraqitet në thirrjen e organizuar dhe njoftuar përmes postës elektronike nga DRAP-ja ose e refuzon vendin e lirë të punës, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë, për një periudhë deri në 2 (dy) vite.

5. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara (AK) nëse ka të tillë, nëse nuk ka persona me AK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka pikët më të larta në testimin e informatizuar. Nëse dhe në testimin e informatizuar i kanë pikët e barabarta, përzgjedhja bëhet me short.

6. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës, pajiset nga DRAP-ja me dokumentin vërtetues për pozicionin e pranuar dhe paraqitet pranë institucionit arsimor parauniversitar, për të lidhur kontratën e punës.

7. Kandidati që përzgjedh vendin e punës dhe punësohet nga institucioni arsimor parauniversitar, me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, hiqet nga lista e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

8. Kandidati fitues punësohet nga drejtori i institucionit arsimor parauniversitar me kontratë pune individuale me afat të pacaktuar, pas kalimit me sukses të periudhës tremujore të provës dhe të vlerësimit pozitiv nga Komisioni për Vlerësimin Psiko-social të Punonjësve Arsimorë dhe punonjësve të tjerë, në institucionet arsimore parauniversitare.

9. DRAP-ja dhe KVD-ja dokumentojnë procesin e përzgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raportojnë me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në AKAP dhe në MAS, emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

10. Kandidati, i cili ka përzgjedhur një vend pune si zëvendësues në profilin përkatës (leje barrëlindjeje, pezullime etj.), qëndron në atë pozicion deri në përfundimin e kontratës së përkohshme të punës dhe me përfundimin e saj rikthehet në portal, në përputhje me pikët e fituara.

11. Në rast se do të ketë vende të lira pune të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët në nivel DRAP-je, këto pozicione u ofrohen kandidatëve të profilit të përafërt me profilin e kërkuar, sipas udhëzimit përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, duke respektuar renditjen.

12. Në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, KVD-ja pranë DRAP-së do të njoftojë të



paraqiten për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve, të cilët në aplikim kanë zgjedhur edhe opsionin “Arsim special” duke respektuar renditjen. Këta kandidatë punësohen me kontratë pune me afat deri në përfundim të vitit shkollor, me të drejtë rinovimi të saj, deri në emërimin e një kandidati nga portali të profilit “Arsim special”.

13. Për institucionet arsimore parauniversitare të arsimit të orientuar, në profilet e artit pamor dhe muzikës, si dhe në lëndët e specialiteteve, punësohen kandidatë nga portali, diplomimi i të cilëve përputhet me kërkesën për vendin e lirë të punës. Këta mësues mund të punësohen edhe në arsimin e mesëm të ulët për lëndët e artit pamor dhe muzikës, sipas renditjes së përgjithshme, me kontrata pune të përkohshme.

14. Të gjithë kandidatët e punësuar, në mungesë të kandidatëve nga portali të profilit përkatës, emërohen me kontratë të përkohshme pune, deri në emërimin e një kandidati të profilit përkatës nga portali. Për këto raste DRAP-ja i drejtohet me kërkesë AKAP-së për miratimin e emërimit të përkohshëm. Këto vende të lira të punës vijnë të mbeten të publikuara në portal.

KREU V

PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE

1. Kur në një institucion arsimor bie numri i orëve mësimore të një profili/lënde, drejtuesi i IAP-së ngre komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë, për të gjithë mësuesit e atij profili/lënde.

2. Komisioni përbëhet nga:

- a) drejtori i shkollës (kryetar);
- b) një mësues i zgjedhur nga këshilli i mësuesve (anëtar);
- c) kryetari i këshillit të prindërve të institucionit (anëtar).

3. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në institucionin arsimor parauniversitar ka për detyrë të bëjë vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve me kontratë pune me afat të pacaktuar të profilit/lëndës për të cilën bie numri i orëve, sipas shtojcës 2, të këtij udhëzimi dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet e vlerësimit.

4. Vlerësimi i dosjeve në shkollat e bashkuara bëhet për të gjithë mësuesit me kontratë pune me afat të pacaktuar, të arsimit të mesëm të ulët ose të

arsimit të mesëm të lartë ku ka rënë ngarkesa mësimore.

5. Drejtori i shkollës përcjell me shkresë zyrtare në ZVAP shtojcën 2, të plotësuar për mësuesin/it që në vlerësimin e dosjeve të kryer nga KVD-ja e shkollës, ka/kanë dalë me më pak pikë dhe ka/kanë ngelur pa ngarkesë mësimore.

6. Mësuesi i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, që dëshiron të kryejë lëvizje paralele brenda ZVAP-së ku është i punësuar, brenda muajit qershor ngarkon në portal dokumentacionin sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi.

7. KVD-ja e DRAP-së, brenda muajit korrik, vlerëson dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele sipas pikës 6 të këtij kreu. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen e DRAP-së dhe të ZVAP-së, si dhe i dërgohen me *email* çdo aplikanti.

8. Kandidati që ka aplikuar për lëvizje paralele brenda të njëjtës ZVAP, ka të drejtë të paraqesë ankesë në DRAP për rezultatin paraprak, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit të rezultatit.

9. KVD-ja e DRAP-së, brenda 3 (tri) ditëve pune, shqyrton ankesat dhe i njofton me *email* çdo kandidati rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjes për lëvizje paralele.

10. KVD-ja e DRAP-së rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëjtën ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP-së, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-në përkatëse.

11. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) dhe më pas atyre të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes së përcaktuar në pikën 10, të këtij kreu.

12. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP-së rezulton se pas njoftimit për punësim, sipas pikës 11 të këtij kreu, ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion, të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë.

13. DRAP-ja njofton AKAP-në në lidhje me punësimet e kryera sipas këtij kreu, e cila i heq nga lista e publikuar këto vende të lira pune.



14. Mësuesit që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të lira, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.

15. Mësuesit e emëruar nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë” u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele, pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.

16. Për lëvizje paralele mund të aplikojnë edhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të institucioneve të arsimit të mesëm profesional që janë punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë” ose para hyrjes në fuqi të udhëzimit për portalin.

KREU VI

PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit në rast se konstatohet njëri nga rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2/1, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpritin marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Drejtori i IAP-së largon mësuesin nga puna, në rast se konstatohet njëri nga rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 60 dhe shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 60/1, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

4. Përpara marrjes së masave të parashikuara në këtë kre, mësuesit i jepet e drejta për t’u dëgjuar.

5. Largimi nga puna i mësuesit bëhet sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Punës dhe Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në ZVAP dhe në DRAP, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin për

arkivat në Republikën e Shqipërisë dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.

2. Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Drejtuesit e DRAP-ve punësojnë si mësues, drejtorë dhe nëndrejtorë në rastet e mëposhtme:

a) Kur drejtori apo nëndrejtori i IAP-së jep dorëheqjen;

b) Kur në institucionet që ata drejtojnë ulet numri i nxënësve nën normën që përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Drejtorët e DRAP-ve punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të fushës së arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast rristurimi, që kanë të paktën 3 vite punë në këto pozicione. Punësimi si mësues bëhet në një institucion arsimor parauniversitar brenda ZVAP-së ku ata kanë paraqitur kërkesën.

5. Në të gjitha rastet e punësimit sipas pikave 3 dhe 4, të këtij kreu, DRAP-ja do të njoftojë AKAP-në, në mënyrë që të hiqet vendi i lirë i punës nga publikimi.

6. Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit në dispozicion nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga



SHTOJCA 1
KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E
PROFESIONIT TË MËSUESIT

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 7 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 10 pikë.	0.5–10 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1–2 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 1.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 2 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); b) Mësues Specialist (kategoria II) 3–4 pikë (3 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 3.5 pikë për vlerësimin “Mirë”, 4 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 5 pikë Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.	0–5 pikë
3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1 = 1 pikë; c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B2 = 2 pikë. Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar. Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.	0–2 pikë
4	Trajnime: Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. i. 1 kredit = 1 pikë; ii. 2 kredite = 2 pikë; iii. mbi 3 kredite = 3 pikë. Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.	0–3 pikë
5	Përvoja në punë si mësimdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor. Kandidati që nuk ka përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.	0–10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)



SHTOJCA 2
KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET
PARALELE

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.	0.5–5 pikë
2	Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1–4 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 2 pikë për vlerësimin “Mirë”, 3 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe 4 pikë për vlerësimin “Shkëlqyeshëm”); b) Mësues Specialist (kategoria II) 5–7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”); c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 8–10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.	0–10 pikë
3	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar. Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.	0–2 pikë
4	Trajnime. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. i. 1 kredit = 1 pikë; ii. 2 kredite = 2 pikë; iii. mbi 3 kredite = 3 pikë. Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.	0–3 pikë
5	Përvoja në punë si mësëmdhënës dhe/ose drejtues institucioni arsimor. Kandidati që nuk ja përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.	0–10 pikë (0.5 pikë për çdo vit pune deri në 20 vite punë)
6	Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5). Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon:	0–2 pikë



	Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	
7	Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social. Punonjësi/it e shërbimit psiko-social vlerësojnë punën e mësuesit me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët” si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë
8	Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë

SHTOJCA 3 VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____.

i/e padënuar i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë, se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një veprë penale, që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____

SHTOJCA 4 DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ - _____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI



SHTOJCË 5



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr. _____ prot. _____, më _____.202__

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE PËR
MËSUESIN/EN _____
PROFILI _____,

Sot në datën _____.202__, ora ____:____, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, z./znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.

Opinion i prindërve mbi mësuesin/en z./znj. _____ është:

1. Dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë mirë

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR

SHTOJCA 6
FORMULAR DEKLARIMI PËR KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: z./znj. _____
Pozicioni aktual i punës: _____
Vendi i punës: _____

Unë nënshkruesi _____
(emër, atësia, mbiemër)

Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve për fazën e konkurrimit me dosje për pozicionin e mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare publike _____, deklaroj, nën përgjegjësinë time të plotë, se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon legjislacioni në fuqi për konfliktin e interesave.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____._____

Nënshkruesi _____
(emër, mbiemër, firmë)

UDHËZIM
Nr. 9, datë 3.5.2024**PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT TË
INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE
PËR T’U PUNËSUAR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME**Neni 1****Organizimi i testimit të informatizuar**

Organizimi i testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përshkruara në këtë udhëzim.

Neni 2**Qendra e testimit dhe afatet e zhvillimit të
testimit të informatizuar**

Testimi i informatizuar i kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA).

Neni 3**Drejtimi, administrimi dhe monitorimi i
testimit të informatizuar**

QSHA-ja drejton, administron dhe monitoron procesin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, si dhe bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) për mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit të testimit të informatizuar.

Neni 4**E drejta e pjesëmarrjes në testimin e
informatizuar**

Në testimin e informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar kanë të drejtë të marrin pjesë:
a) kandidatët që kanë zgjedhur që në të njëjtën ditë me provimin e licencimit për ushtrimin e



profesionit të rregulluar të mësuesit dhe e kanë kaluar me sukses këtë provim, të kryejnë edhe testimin e informatizuar për të konkurruar për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”;

b) kandidatët që zgjedhin të kryejnë vetëm testimin e informatizuar, për pjesëmarrje në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Neni 5

Vlerat udhëheqëse dhe parimet e procesit

Procesi i testimit të informatizuar udhëhiqet nga vlerat e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritës së kandidatëve, duke respektuar parimet e mëposhtme:

- a) ruajta e fshehtësisë së fondit të pyetjeve;
- b) korrekhtësia e kandidatëve në mjedisin e testimit;
- c) korrekhtësia e administrimit;
- ç) vlerësimi i standardizuar.

KREU II

DETYRAT DHE KOMPETENCAT E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

Neni 6

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj programet orientuese të testimit të informatizuar sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë kandidati, si dhe referencat e literaturës;

b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve me alternativa, që do të përdoret për çdo testim sipas profilit përkatës;

c) merr në dorëzim zyrtarisht me procesverbal, nga hartuesit e fondit të pyetjeve, fondin e pyetjeve me alternativa të çdo profili, për të cilin do të zhvillohet testimi;

ç) organizon fondin e pyetjeve nëpërmjet koordinаторit të profilit lëndor përkatës, i cili vlerëson dhe miraton saktësimin e përmbajtjes së fondit të pyetjeve sipas kriterëve të përcaktuara nga QSHA-ja;

d) dorëzon zyrtarisht me procesverbal në QSHA fondin përfundimtar të pyetjeve me alternativa, të miratuar për çdo profil lëndor, në format elektronik;

dh) përcakton dhe publikon në faqen zyrtare të institucionit informacionin për strukturën përmbajtësores të testit;

e) dorëzon zyrtarisht në QSHA strukturën e testit për çdo profil testimi, për të dyja kategoritë e përcaktuara në nenin 4, të këtij udhëzimi.

Neni 7

Detyrat dhe kompetencat e Qendrës së Shërbimeve Arsimore

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është përgjegjëse për zhvillimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. QSHA-ja zbaton procedurat për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale.

2. QSHA-ja, lidhur me zhvillimin e testimit të informatizuar, kryen detyrat e mëposhtme:

a) merr në dorëzim fondin e pyetjeve për çdo profil lëndor të miratuar nga ASCAP-i;

b) merr në dorëzim strukturat e testit për çdo profil lëndor që do të zhvillohet për kandidatët, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, të cilët kanë përmbushur detyrimin e pajisjes me licencë;

c) merr në dorëzim strukturat e testit për çdo profil lëndor që do të zhvillohet për kandidatët, për t'u punësuar në institucionet arsimore parauniversitare, të cilët në të njëjtën ditë me zhvillimin e testimit të informatizuar të portalit japin edhe provimin e licencës për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit;

ç) digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo profil lëndor të informatizuar;

d) harton kalendarin e testimit të informatizuar sipas profileve lëndore të përcaktuara në këtë udhëzim, pas marrjes në dorëzim të listave të kandidatëve nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP). Lista e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të informatizuar dërgohet 1 (një) javë para fillimit të sesionit të zhvillimit të testimit të informatizuar dhe përmban këto të dhëna: emër, atësi, mbiemër, ID, profili, zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP-të) ku dëshiron të konkurrojë kandidati;



dh) publikon listat e kandidatëve sipas profilit, datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e testimit në portalin “Mësues për Shqipërinë”;

e) verifikon identitetin përmes dokumenteve përkatëse të kandidatëve (pasaportë biometrike/kartë identiteti) pjesëmarrës në testimin e informatizuar;

ë) siguron kushte të përshtatshme në sallat e përcaktuara për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale;

f) siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara;

g) merr masa për gjenerimin e tezës sipas strukturës së testimit të informatizuar të miratuar nga ASCAP-i;

gj) mban procesverbale për çdo vendimarrje gjatë procedurave të zhvillimit të testimit të informatizuar, deri në shpalljen e rezultateve;

h) dërgon në AKAP dhe në MAS rezultatet e testimit përfundimtar;

i) harton raportin statistikor, lidhur me rezultatet e testimit të informatizuar dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për arsimin;

j) në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) shqyrton ankimimet për testimin e informatizuar të kandidatëve, të cilët kanë të drejtën e ankimimit brenda tri (3) ditëve nga shpallja e rezultatit.

Neni 8

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar

AKAP-ja, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) kryen detyrat e mëposhtme:

a) përgatit listën e kandidatëve të parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 4, të këtij udhëzimi, të cilët do të marrin pjesë në testimin e informatizuar dhe e dërgon në QSHA;

b) bashkëpunon dhe mbështet QSHA-në për mbarëvajtjen e testimit të informatizuar.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatëve gjatë testimit të informatizuar

1. Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

a) të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë biometrike);

b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;

c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;

ç) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;

d) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit;

dh) të jenë të pajisur me formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, i cili lëshohet nga komisioni i vlerësimit të dosjeve të DRAP-së.

2. Nëse një kandidat nuk paraqitet në testim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë testi nuk vlerësohet si i kryer.

3. Tërheqja nga testi i informatizuar nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e testimit.

4. Kandidati që del nga salla e testimit, nuk do të rihijë në sallë gjatë zhvillimit të testimit.

Neni 10

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nëpërmjet dy fazave:

a) faza e parë: vlerësimi me pikë nga dokumentet e dosjes së kandidatit (në masën 30 pikë);

b) faza e dytë: vlerësimi nga testi i informatizuar (në masën 70 pikë).

2. Teza e testimit të informatizuar për kandidatët e parashikuar në shkronjën “b”, të nenit 4, të këtij udhëzimi, përmban 50 pyetje, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100 pikë. Pikët që kandidati fiton nga testi i informatizuar konvertohen maksimalisht në 70 pikë, duke shumëzuar numrin e pikëve që kandidati ka marrë në testimin e informatizuar me 0.7.

3. Pikët e parashikuara për kandidatët e parashikuar në shkronjën “a”, të nenit 4, të cilët në të njëjtën ditë me provimin e licencës kanë zgjedhur të kryejnë edhe testimin e informatizuar vlerësohet si më poshtë:

a) Provimi i licencës 40 pikë (sasia e pikëve që kandidati fiton nga provimi i licencës shumëzohet me 0.4.);

b) Testimi i informatizuar për njohuritë psiko-pedagogjike 30 pikë.



4. QSHA-ja bën konvertimin e vlerësimit të testimit të informatizuar dhe ua dërgon AKAP-së dhe MAS-it.

KREU III ORGANIZIMI I TESTIMIT TË INFORMATIZUAR

Neni 11

Programet orientuese

1. Programet orientuese për testimin e informatizuar hartohen dhe publikohen nga ASCAP-i për të dyja kategoritë e parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi. Hartimi i tyre bëhet mbi bazën e kurrikulës së arsimit parauniversitar sipas profilit përkatës.

2. Programi orientues për arsimin parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.

3. Programi orientues për arsimin fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.

4. Programet orientuese për të gjitha profilet bazohen në programet lëndore përkatëse.

5. Programet orientuese për kandidatët e profileve artistike bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit figurativ dhe baletit.

6. Programet orientuese për kandidatët e arsimit special përgatiten sipas programeve të formimit të përgjithshëm të përgatitur nga ASCAP-i.

Neni 12

Llojet e testimit të informatizuar

Provimi i testimit të informatizuar realizohet për profilet/lëndët e mëposhtme:

Arsimi parashkollor, arsimi fillor, gjuhë shqipe dhe letërsi, gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë italiane, gjuhë gjermane, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK), shkenca sociale, ekonomi, edukim fizik, muzikë, art pamor, arsim special, muzikë për shkollat artistike, art pamor për shkollat artistike, balet.

Neni 13

Hartimi i fondit të pyetjeve

1. ASCAP-i ngre grupe pune për hartimin e fondit të pyetjeve për zhvillimin e testimit të

informatizuar për kandidatët, për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, sipas profileve të testimit të informatizuar me përfaqësues mësues dhe specialistë të sistemit të arsimit parauniversitar.

2. Fondi i pyetjeve hartohet në bazë të standardeve të përcaktuara nga QSHA-ja dhe pyetjet grupohen si më poshtë:

a) në pjesë/module sipas grupeve kryesore të profileve;

b) nivele vështirësie: Niveli 1: i lehtë, Niveli 2: mesatar dhe Niveli 3: i vështirë, duke u konvertuar respektivisht në 1 pikë, 2 pikë dhe 3 pikë të tezës.

3. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të ndryshuar.

4. Grupet e hartuesve dorëzojnë fondin e pyetjeve për testimin e informatizuar në ASCAP, i cili miraton fondin e pyetjeve dhe raportin e disiplinave sipas programeve orientuese.

Neni 14

Miratimi i fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në lidhje me fondin e pyetjeve për çdo profil, ndjek procedurat e mëposhtme:

a) merr në dorëzim me procesverbal nga hartuesit fondet e pyetjeve të testimit të informatizuar dhe i miraton ato;

b) shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:

i. peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes. Kur konstatohet se nuk përmbushen këto kushte, ndryshon formulimin e pyetjes, duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve ose e heq atë;

ii. përcaktimin e vështirësisë së pyetjeve duke bërë ndryshime, nëse e sheh të arsyeshme;

iii. përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe përgjigjeve respektive të çdo profili;

c) përcakton raportin në përqindje të përfshirjes së pyetjeve të ndara sipas nivelit të vështirësisë, në



përputhje me karakteristikat e programit të informatizuar të QSHA-së;

ç) i dorëzon QSHA-së fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse ku saktësohet përgjigja e saktë.

Neni 15

Mbarëvajtja e zhvillimit të testimit të informatizuar

1. Testimi i informatizuar zhvillohet sipas kalendarit të hartuar nga QSHA-ja, në bazë të mundësisë së sigurimit të ambienteve të testimit.

2. Sallat ku do të zhvillohet testimi, mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë të caktuar nga QSHA-ja. Administratorët mbikëqyrës janë përgjegjës për mbarëvajtjen e testimit sipas përcaktimit në këtë udhëzim.

3. Në ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar duhet të jenë të pranishëm 1–2 përfaqësues nga ASCAP-i, të cilat asistojnë në prodhimin elektronik të tezës së testimit të informatizuar dhe mbajnë procesverbal për saktësinë e procedurës së ndjekur dhe pyetjeve të përzgjedhura nga sistemi.

4. Përfaqësuesit e ASCAP-it ndjekin procedurat e zhvillimit të testimit të informatizuar në QSHA deri në përfundimin e testimit dhe nënshkruajnë procesverbalin me rezultatet e testimit, përmes videomonitorëve.

Neni 16

Modalitetet e zhvillimit të testimit të informatizuar

1. Për çdo seancë testimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testimin e informatizuar.

2. Testimi i informatizuar për kandidatët e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 4, të këtij udhëzimi, zgjat 30 minuta dhe përmban 20 pyetje të cilat maksimalisht vlerësohen me 30 pikë, ndërsa testimi i informatizuar për kandidatët e përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 4, zgjat 60 minuta dhe përmban 50 pyetje, të cilat maksimalisht vlerësohen me 70 pikë.

3. Provimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni zhvillohen vetëm me një raund. Ato fillojnë dhe

mbarojnë njëkohësisht për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testim, në ditën dhe orarin e caktuar.

4. Vlerësimi i kandidatëve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në çastin e përfundimit të testimit. Rezultati përfundimtar i shfaqet kandidatit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo kandidat nënshkruan fletën me rezultatet e testimit të printuar në përfundim të testimit përkatës.

5. QSHA-ja ka të drejtë që, në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, t'u propozojë përfaqësuesve të ASCAP-it përjashtimin e kandidatit që thyen rregullat. QSHA-ja mban procesverbal, ku evidenton shkeljet e konstatuara.

6. Nëse konstatohet se testimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, testimi për kandidatët e asaj sale do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të QSHA-së dhe të përfaqësuesve të ASCAP-it.

Neni 17

Konflikti i interesit

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve nuk duhet të jenë autorë të teksteve dhe të librave ndihmës për nxënësit (përveç atyre që botohen nga institucionet e varësisë të MAS-it).

2. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga ASCAP-i nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes).

3. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga ASCAP-i nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në institucionet përkatëse.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



Neni 19

Mbulimi i shpenzimeve

Shpenzimet për realizimin e testimit të kandidatëve që aplikojnë për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar përballohen nga buxheti i institucioneve respektive që përfshihen në këtë proces, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 20

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 12, datë 27.2.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet

arsimore publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 21

Zbatimi i udhëzimit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe njësitë arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

